

Ligji për Qytetin e Prishtinës

Seria e Hulumtimeve Parlamentare

20 shtator 2010

Hyrje

Prishtina është kryeqytet i Republikës së Kosovës. Neni 13 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe Ligji për Vetëqeverisje Lokale parashohin që statusi i kryeqytetit të rregullohet me ligj të veçantë. Gjithashtu, në Programin Qeverisës 2008 – 2011 të Qeverisë aktuale parashihet nxjerrja e ligjeve për qytetet e mëdha.¹ Megjithatë, edhe pas afro tri viteve të qeverisjes së Qeverisë aktuale, pas dy viteve të hyrjes në fuqi të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, Prishtina nuk ka një ligj të vetin, ashtu siç parashihet me këto programe dhe ligje.

Projektligji për Prishtinën është miratuar nga Qeveria e Kosovës më 23 prill 2009², kurse i është dërguar Kuvendit më 29 qershor 2010, pas plotë 432 ditësh. Instituti për Studime të Avancuara GAP në vazhdimësi ka monitoruar zhvillimet lidhur me Projektligjin e Prishtinës dhe ka përgatitur një analizë rreth përmbajtjes së këtij ligji, në formën aktuale që i është dërguar Kuvendit të Kosovës.

Parregullsitë procedurale me Projektligjin për Prishtinën

Pas 432 ditësh të miratimit të Projektligjit për Qytetin e Prishtinës, Qeveria i ka dërguar Kuvendit këtë projektligj për shqyrtim dhe miratim. Projektligji që është dërguar në Kuvend për miratim nuk është ai i cili është miratuar në Qeveri. Këto dy projektligje ndryshojnë në dy pika: granti qeveritar për Qytetin e Prishtinës, i cili në draftin e miratuar në Qeveri ishte 4% dhe në draftin e dërguar në Kuvend është 3%, si dhe pika për Pallatin e Rinisë dhe të Sporteve, ku në draftin e miratuar në

Qeveri ky objekt përmendej në pikën 8.1.2, kurse në draftin e dërguar në Kuvend ky objekt nuk përmendet fare.

Edhe pse Projektligji për Qytetin e Prishtinës i ka kaluar të gjitha fazat e vlerësimit të ndikimit buxhetor, ashtu siç parashihet me Rregulloren e Punës së Qeverisë së Kosovës³, projektligji i dërguar në Kuvend nuk e ka deklaratën financiare, ashtu siç parashihet me Rregulloren e Punës së Kuvendit të Kosovës.⁴ Kuvendi e ka pranuar këtë projektligj, edhe pse përbën shkelje të Rregullores së Punës së Kuvendit të Kosovës. Si rrjedhojë, nuk është bërë e ditur, se përveç grantit prej 3%, sa do ti kushtoj Buxhetit të Kosovës hyrja në fuqi e Ligjit për Qytetin e Prishtinës?

Përmbajtja e Projektligjit për Qytetin e Prishtinës

Projektligji për Qytetin e Prishtinës përmban gjithsejtë 10 nene. Në këtë analizë do të fokusohemi në pikat që kanë të bëjnë me vetëqeverisje lokale (neni 2 dhe neni 4.2), kufijtë komunal (neni 2.3), granti qeveritar (neni 8.4), menaxhimi me objektet dhe terrenet sportive (neni 8.6), zonën metropolitane të Prishtinës (neni 9).

Vetëqeverisja lokale në Prishtinë dhe komunat tjera

Ligji për Vetëqeverisje lokale, i cili ka hyrë në fuqi më 15 qershor 2008, ashtu si Kushtetuta, parasheh nxjerrjen e një ligji të veçantë për Qytetin e Prishtinës. Sipas nenit 2.2, “Qyteti i Prishtinës, si kryeqytet i Republikës së Kosovës do të qeveriset përmes një ligji të ri për Qytetin e Prishtinës. Ligji mbi vetëqeverisjen lokale do të zbatohet për Qytetin e Prishtinës, përveç nëse parashihet ndryshe në ligjin për Qytetin e Prishtinës.” E njëjta gjë përsëritet edhe në Projektligjin për Qytetin e Prishtinës: Ligji për Vetëqeverisje Lokale dhe Ligji për Financat e Pushtetit Lokal aplikohen për Qytetin e Prishtinës, përveç nëse përcaktohet ndryshe me këtë ligj.⁵

Sipas kësaj, Ligji për Qytetin e Prishtinës ka epërsi ndaj Ligjit për Vetëqeverisje Lokale. Në shumë pika, vetëqeverisja lokale në Qytetin e Prishtinës, sipas projektligjit, ndryshon nga vetëqeverisja lokale në komunat e tjera të Republikës së Kosovës. Sipas Projektligjit për Prishtinën, Kryetari i Qytetit të Prishtinës është edhe Kryesues i Kuvendit të Qytetit të Prishtinës dhe Kryesues i Komitetit për Politikë dhe Financa.⁶ Kryetari i Qytetit të Prishtinës nuk është anëtar i Kuvendit të Komunës dhe Komitetit për Politikë dhe Financa por e ka të drejtën e votës shtesë në rast të numrit të njëjtë të votave për ose kundër ndonjë propozimi.⁷ Kjo bie ndesh me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale. Sipas këtij ligji, kuvendi i komunës e zgjedh kryesuesin e kuvendit të komunës nga radhët e anëtarëve.⁸ Rendi i ditës për takimin e kuvendit të komunës caktohet nga kryesuesi i kuvendit të komunës në marrëveshje me Kryetarin e Komunës.⁹

Përderisa Ligji për Vetëqeverisje Lokale bën një ndarje të prerë në mes legjislativit dhe ekzekutivit komunal, Projektligji për Qytetin e Prishtinës bën përzjerjen e këtyre dy degëve të qeverisjes, duke paraparë që ato të udhëhiqen nga i njëjti individ. Pjesëmarrja në kryesim dhe votim e Kryetarit të Komunës në Kuvendin

Komunal, pa qenë anëtar i zgjedhur i Kuvendit, bën që Kuvendi Komunal i Prishtinës gjatë tërë funksionimit të tij të ketë 52 anëtarë, një më shumë se sa e parasheh Ligji për Vetëqeverisje Lokale.¹⁰

Kuvendi i Kosovës, i cili ka miratuar Ligjin për Vetëqeverisje Lokale në shkurt të 2008, duhet të vendos se a është kjo çfarë është menduar me nenin 2.2 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, kur i është lënë hapësirë e plotë Qytetit të Prishtinës që të rregulloj statusin e tij me ligj të veçantë. Në rast se Projektligji për Qytetin e Prishtinës miratohet në këtë formë, Kuvendi i Kosovës duhet të amendamentoj edhe Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, sidomos nenet 41.1, 47.1 dhe 36.2.

Kufijtë e Prishtinës

Me Projektligjin për Qytetin e Prishtinës, kufijtë e Qytetit të Prishtinës janë të njëjtë me kufijtë e Komunës së Prishtinës, të përcaktuar si me Ligjin për Kufijtë Administrativ të Komunave.¹¹ Sipas Ligjit për Kufijtë Administrativ të Komunave, Komuna e Prishtinës përbëhet prej 42 vendbanimeve: Qytetit të Prishtinës dhe 41 fshatrave.¹² Sipas Projektligjit, tani propozohet që Qyteti dhe Komuna, në rastin e Prishtinës, të jenë e njëjta gjë. Apo, vendbanimet si Hajkobilla e Mramori, tani do të jenë pjesë e Qytetit të Prishtinës. Ky përkufizim i tërë territorit aktual të komunës si qytet është i paqartë. Në ligjin për Planifikim Hapësinor, në nenin 2 ku flitet për përkufizimet, jepen definicionet e fshatit dhe qytetit. “Qytet” nënkupton vendbanimin të cilin kuvendi i komunës, duke marrë për bazë shkallën e ndërtimit, veprimtaritë dhe karakteristikat tjera të karakterit urban, e ka përcaktuar si të tillë. “Fshati” është vendbanimi në të cilin popullsia merret kryesisht me veprimtari bujqësore.¹³

Kushtetuta e Kosovës si njësi themelore territoriale të vetëqeverisjes lokale në Republikën e Kosovës njeh vetëm komunat¹⁴ dhe jo ndonjë njësi tjetër siç parashihet të jetë Qyteti i Prishtinës, përmes Kufijve dhe organeve të tij – Kryetari dhe Kuvendi i Qytetit.

Zona Metropolitane e Prishtinës

Ashtu siç e potencon edhe Projektligji për Qytetin e Prishtinës, Prishtina është e lidhur ngushtë dhe ndikohet nga zhvillimet e komunave për rreth. Burimet e ujit Qyteti i Prishtinës i ka në Komunën e Graçanicës dhe atë të Podujevës, ndotja më e madhe në Qytetin e Prishtinës krijohet nga termocentralet në Komunën e Kastriotit; Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës ndodhet në territorin e Komunës së Lipjanit (nuk është i largët konflikti në mes Komunës së Prishtinës dhe asaj të Lipjanit për lejet e taksive); si dhe Qyteti i Prishtinës ka një lidhje të pandarë urbane me qytetin e Fushë Kosovës.

Me Projektligjin për Qytetin e Prishtinës, parashihet krijimi i Zonës Metropolitane të Prishtinës. Gjashtë muaj pas hyrjes në fuqi të Ligjit për Qytetin e Prishtinës, Qyteti i Prishtinës hyn në marrëveshje me komunat Podujevë, Lipjan, Fushë Kosovë, Kastriot/Obiliq dhe Graçanicë. Edhe me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale u jepet hapësirë komunave që të arrijnë bashkëpunim ndërkomunal, madje edhe

ndërkufitar. Po ashtu edhe me Ligjin për Planifikim Hapësinor thuhet se dy e më tepër komuna mund të përgatisin planin e përbashkët zhvillimor.¹⁵ Mirëpo, edhe Ligji për Vetëqeverisje Lokale e edhe ai për Planifikim Hapësinor, bashkëpunimin ndërkomunal e parashohin në suaza vullnetare dhe kurrësi imponuese. Kurse Ligji për Qytetin e Prishtinës, obligon komunat fqinje që 6 muaj pas hyrjes së ligjit në fuqi ato të arrijnë një marrëveshje bashkëpunimi. Çka nëse njëra ose më shumë komuna fqinje nuk dëshirojnë që të hyjnë në marrëveshje bashkëpunimi? Cili është ai mekanizëm që do ti detyronte ato që të hyjnë në marrëveshje bashkëpunimi me Qytetin e Prishtinës për të krijuar Zonën Metropolitane? Nëse thirrëmi në parimet e vetëqeverisjes lokale, nuk do të duhej që të ekzistonte një mekanizëm, qoftë edhe Ligji për Qytetin e Prishtinës, që ti obligoj qytetet tjera që të bashkëpunojnë me Qytetin e Prishtinës. Me këtë rast ato qytete nuk do të kishin një vetëqeverisje lokale.

Për të evituar këtë, ligji duhet që të parashohë që marrëveshja për Zonën Metropolitane të Prishtinës, së bashku me organet dhe financimin e kësaj zone, duhet që të miratohen veç e veç nga kuvendet komunale të të gjitha komunave fqinje të Qytetit të Prishtinës.

Granti për Qytetin e Prishtinës

Një nga pikat më diskutuese në këtë projektligj ka qenë dhe mbetet granti shtesë për Qytetin e Prishtinës. Versioni paraprak i Projektligjit për Qytetin e Prishtinës obligonte Qeverinë e Kosovës që Qytetit të Prishtinës ti ndaj një grand shtesë prej më së paku 4% të grandit total të komunave për secilin vit fiskal. Verzioni i dërguar në Kuvend, ul këtë grand në 3%.

Në bazë të Buxhetit të Kosovës për vitin 2010, grandit total i komunave për 2010 është pak më shumë se 234 milion Euro (vlerësimi për 2011 është afro 236 milion Euro dhe për 2012 mbi 244 milion Euro. 3% e kësaj shume është mbi 7 milion Euro (me rritje progresive, varësisht prej rritjes së grandit për komunat).

Krijimi i distrikteve me staf të ri dhe me organe të reja, krijon edhe shpenzime shtesë për Qytetin e Prishtinës. Gjithashtu edhe krijimi i Zonës Metropolitane të Prishtinës kërkon shpenzime shtesë buxhetore. Mirëpo, në ligj nuk specifikohet askund se grandit shtesë për 3% për çfarë qëllimesh do të përdoret: investime kapitale, për krijimin dhe mbarëvajtjen e Zonës Metropolitane, financimin e distrikteve apo do ti bashkëngjitet totalit të buxhetit të komunës dhe do të shpenzohet sikurse pjesa tjetër e buxhetit? Nëse granti shtesë prej 3% nuk ka destinim të caktuar, atëherë a do të jenë të gatshme komunat fqinje të Qytetit të Prishtinës që të ndajnë buxhet komunal të mjaftueshëm për mbarëvajtjen e Zonës Metropolitane? A do të kërkojnë komunat tjera hise në grantin prej 3%?

Mënyra e financimit të Zonës Metropolitane, gjithashtu duhet të vendoset me vendim të kuvendeve komunale, ngase për mënyrën e ndarjes së buxhetit komunal autoriteti që vendos për këtë është kuvendi i komunës.

Menaxhimi me objektet dhe terrenet sportive

Versioni i kaluar i Projektligjit për Qytetin e Prishtinës, në nenin 8 pika 1.2, përfshinte edhe Pallatin e Rinisë dhe të Sporteve si objekt sportiv që do të menaxhohet nga Qyteti i Prishtinës. Versioni i dërguar në Kuvend mjaftohet vetëm me përkufizimin se “Qyteti i Prishtinës menaxhon me objektet dhe terrenet sportive”.¹⁶ Versioni i dërguar në Kuvend krijon paqartësi edhe më të madhe lidhur me atë se në “objektet dhe terrenet sportive” a përfshihet edhe Pallati i Rinisë dhe i Sporteve?

Pallati i Rinisë dhe i Sporteve është bërë objekt diskutimi në mes Komunës së Prishtinës, Qeverisë së Kosovës dhe tani së fundmi edhe i Komisionit Evropian. Ky objekt nuk ndodhet, me të drejtë, në listën e ndërmarrjeve shoqërore me të cilat menaxhon Agjencioni Kosovar i Pronës (AKP). Gjithashtu, ky objekt nuk përfshihet as në Ligjin për Ndërmarrjet Publike, as në listën e ndërmarrjeve publike qendrore e as në atë ndërkomunale.

Pallati i Rinisë dhe i Sporteve do të duhej të ishte nën menaxhimin e Qytetit të Prishtinës. Në rast të konfliktit në mes të Qytetit të Prishtinës dhe komunave fqinje, Kastriotit/Obiliqit dhe Fushë Kosovës, atëherë Pallati i Rinisë dhe i Sporteve do të duhej që të menaxhohej nga një bord i përbashkët në mes të tri komunave. Tani, me kërkesën për krijimin e Zonës Metropolitane, me siguri që komunat fqinje të Prishtinës, që dikur kanë qenë pjesë e territorit të Prishtinës, do të kushtëzojnë bashkëpunimin me lejimin e pronësisë në Pallatin e Rinisë dhe të Sporteve.

Çështje tjera që duhet të adresohen me Ligjin për Qytetin e Prishtinës

Prishtina është kryeqyteti i Kosovës. Si e tillë në këtë qytet janë të vendosura selitë administrative të institucioneve qendrore dhe ndërkombëtare. Në të kaluarën, Qyteti i Prishtinës ka hasur në probleme të shumta me menaxhimin e pronës publike në pjesët ku kanë qenë të vendosura objektet administrative qendrore dhe ndërkombëtare. Rasti më i njohur është ai i menaxhimit me rrethojat e institucioneve publike. Në korrik të 2008, Instituti për Studime të Avancuara GAP, me një letër të hapur i kishte kërkuar Komunës së Prishtinës që të largoj të gjitha rrethojat e hekurta që ndodhen rreth institucioneve publike.¹⁷ Përgjigja e Komunës së Prishtinës ishte se largimi i rrethojave po pamundësohet për shkak të mos dëgjueshmërisë së institucioneve qendrore dhe ndërkombëtare.

Rast tjetër i konfliktit në mes të Qytetit të Prishtinës dhe nivelit qendror janë punimet rrugore në hyrjet e Qytetit të Prishtinës. Komuna akuzon nivelin qendror për mos ndërtim të nënkalimeve tek stacioni i autobusëve, për mos koordinim të planeve për ndërtimin e rreth rrotullimit tek lagja Dardania, tollovinë në hyrjen nga Veterniku, etj.

Andaj, një ligj për Qytetin e Prishtinës duhet që ti adresoj problemet e ndryshme që mund të dalin si këto në mes të nivelit lokal dhe atij qendror. Për shkak se Zona Metropolitane që parashihet të krijohet përfshin edhe rrugë magjistrale, që për

momentin janë kompetencë e nivelit qendror, në këtë zonë do të duhej që të parashihej edhe përfaqësimi i organeve qendrore, si për shembull përfaqësues të Ministrisë së Transportit, asaj të Shëndetësisë, etj.

Nevoja për krijimin e një njësie për harmonizim të ligjeve mes vete

Sipas Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës, gjatë miratimit të një projektligji, ai duhet të kaloj edhe nëpër fazën e vlerësimit të ndikimit buxhetor, rregullativ dhe përputhshmërisë së tij me parimet e legjislacionit të përbashkët të BE. Që nga themelimi i Institucioneve të Përkohshme Vetëqeverisëse më 2001, Kuvendi i Kosovës ka miratuar 152, kurse 40 tjera janë në procedurë për tu miratuar.¹⁸ Rritja e numrit të ligjeve në fuqi, ditë e më shumë po krijon një problem i cili, për shkak të numrit të vogël të ligjeve, nuk është vërejtur në vitet e mëhershme. E kjo është konflikti në mes të ligjeve. Me rastin e dërgimit të Projektligjit të Punës në Kuvend, muaj më parë, drafti i këtij projektligji binte ndesh me së paku një ligj: Ligjin për Promovimin e të Ushqyerit me Qumësht Gjiri.

Edhe Projektligji për Qytetin e Prishtinës, përfshinë norma të cilat janë rregulluar ndryshe me ligjet tjera në fuqi, si Ligji për Vetëqeverisje Lokale, Ligji për Planifikim Hapësinor, Ligji për Kufijtë Administrativ Komunal, etj. Andaj Kuvendi i Kosovës dhe Qeveria duhet të themelojnë një njësi e cila do të harmonizoj ligjet në mes vete dhe projektligjet e reja me ligjet në fuqi. Kjo do të evitoj konfliktet në mes ligjeve. Me rastin e dërgimit të një projektligji të ri në Kuvend, ai duhet që të ketë bashkangjitur edhe deklaratën e përputhshmërisë me legjislacionin në fuqi.

Përmbledhje dhe rekomandime

Prishtina duhet që të ketë ligj të vetin. Kjo parashihet edhe me nenin 13 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Projektligji për Qytetin e Prishtinës është njëri nga projektligjet i cili është zvarritur më së shumti.

Drafti i dërguar në Kuvend përmban paqartësi të shumta të cilat duhet që të zgjidhen para se ky dokument të marr statusin e ligjit.

Instituti për Studime të Avancuara GAP rekomandon që:

1. Vetëqeverisja komunale në Qytetin e Prishtinës nuk duhet të dalloj nga vetëqeverisja komunale në qytetet tjera të Kosovës. Në rast se lejohet që Projektligji për Qytetin e Prishtinës të miratohet në këtë formë, nevojitet amendamenti i Ligjit për vetëqeverisje lokale, sidomos në pikat që kanë të bëjnë me përjashtimet për kryesuesin e kuvendit komunal, kryesuesin e Komitetit për Politikë dhe Financa, përcaktimin e rendit të ditës për kuvendin komunal, anëtarësinë e Kuvendit Komunal të Prishtinës, etj. Por, për cilindo rast që vendoset, që kryetari i komunës të jetë edhe kryesues i kuvendit komunal apo jo, ky vendim duhet të bëhet në bazë të një vlerësimi paraprak se përse është më mirë që kryetari i komunës të jetë edhe kryesues i kuvendit. Në rast se argumentet ndodhen në anën e asaj

se kryetari është më mirë të jetë edhe kryesues i kuvendit, atëherë kjo do të ishte më mirë të aplikohet edhe në komunat tjera.

2. Projektligji për Qytetin e Prishtinës duhet të harmonizohet me Ligjin për Planifikim Hapësinor. Sidomos të qartësohet më tepër se çfarë nënkuptohet me njësimin e kufijve të Qytetit të Prishtinës me kufijtë e Komunës së Prishtinës.
3. Zona Metropolitane e Prishtinës nuk guxon ti imponohet me ligj komunave fqinje të Prishtinës. Kjo do të ishte në kundërshtim me parimet e vetëqeverisjes lokale për komunat e Kosovës. Ligji duhet që të parashoh miratimin e Zonës Metropolitane, se bashku me përfaqësimin dhe buxhetin, nga ana e kuvendeve komunale të Fushë Kosovës, Graçanicës, Kastriotit/Obiliqit, Lipjanit dhe Besianës/Podujevës.
4. Granti qeveritar prej 3% duhet që të specifikohet se për çfarë qëllimi do të destinohet.
5. Në ligj duhet që të ceket qartazi se a do të menaxhoj Qyteti i Prishtinës me Pallatin e Rinisë dhe të Sporteve? Në rast se nuk bëhet një qartësim i tillë me ligj, konflikti në mes Qytetit të Prishtinës dhe institucioneve qendrore do të vazhdoj edhe më tutje. Pallati i Rinisë do të duhej të menaxhohej nga Qyteti i Prishtinës ose përmes bordit të përbashkët të Qytetit të Prishtinës, Komunës së Kastriotit/Obiliqit dhe Fushë Kosovës.
6. Ligji për Qytetin e Prishtinës duhet të adresoj edhe konfliktet në mes të Qytetit të Prishtinës dhe nivelit qendror, qoftë përmes dhënies së kompetencave të plota për menaxhimin e pronës publike (përfshirë hapësirën rreth institucioneve qendrore dhe ndërkombëtare), apo përmes inkuadrimin të institucioneve qendrore në Zonën Metropolitane të Prishtinës.

Instituti për Studime të Avancuara GAP është një Think-Tank i themeluar në tetor të 2007 në Kosovë. Qëllimi kryesor i GAP-it është të tërheq profesionistë për të krijuar një ambient të zhvillimit dhe hulumtimit profesional, që haset në institucione të ngjashme në shtetet perëndimore. Kjo gjithashtu u ofron mundësi kosovarëve për hulumtimin, zhvillimin dhe implementim e projekteve me qëllim të avancimit të shoqërisë kosovare. Prioritet për këtë Institut është mobilizimi i profesionistëve në adresimin e sfidave ekonomike, politike dhe sociale të vendit. Qëllimet kryesore të GAP-it janë të mbush zbrazëtitë në mes të qeverisë dhe qytetarëve, si dhe të mbushë zbrazëtitë në mes të problemeve dhe zgjidhjeve.

Instituti për Studime të Avancuara GAP përkrahet nga:



¹ Programi i Qeverisë së Republikës së Kosovës 2008 – 2011 (http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Programi_Qeveritar_2008_-_2011.pdf)

² Në mbledhjen e 61 të Qeverisë, vendimi 18/61, 23 prill 2009.

³ Neni 25 pika 6 e Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës, 2007.

⁴ Neni 54, pika d e Rregullores së Punës së Kuvendit të Kosovës, e miratuar më 29 prill 2010.

⁵ Neni 2, pika 2 e Projektligjit për Qytetin e Prishtinës.

⁶ Neni 4.2 i Projektligji për Qytetin e Prishtinës.

⁷ Po aty, neni 4.3.

⁸ Neni 41.1 i Ligjit për Vetëqeverisje Lokale.

⁹ Neni 47.1. i Ligjit për Vetëqeverisje Lokale.

¹⁰ Neni 36.2 i Ligjit për Vetëqeverisje Lokale.

¹¹ Neni 2.3 i Projektligji për Qytetin e Prishtinës.

¹² Shtojca 1 e Ligjit për Kufijtë Administrativ të Komunave.

¹³ Neni 2 i Ligjit për Planifikim Hapësinor.

¹⁴ Neni 12.1 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

¹⁵ Neni 13.5 i Ligjit për Planifikim Hapësinor.

¹⁶ Neni 8 pika 6 e Projektligjit për Qytetin e Prishtinës, versioni i protokolluar në Kuvend.

¹⁷ Instituti për Studime të Avancuara GAP. Letër e Hapur Komunës së Prishtinës. <http://institutigap.org/?cid=1,5,6>

¹⁸ Kuvendi i Kosovës. Evidenca e Ligjeve. (së fundmi e rifreskuar më 17.6.2010) <http://kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/Evidenca%20e%20ligjeve-shqip.pdf>